

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

4993
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 10/12/2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 88

Datë: 05.12.2025 si dhe projekt-vendimin nr.08 Datë 19.11.2025.

**“MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL
“SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË” I FINANCUAR ME FONDET
E BUXHETIT TË SHTETIT, NË BASHKINË E DIBRËS”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ilir Elezi



Kopja
10-12-2025
Atel



4993/11/12/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBER

Nr.1115/1 prot.

Peshkopi, më 11.12.2025

Lënda : Për vendimin nr.88, datë 05.12.2025 të Këshillit të Bashkisë Diber.

KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR

BASHKISË DIBËR

DIBËR


Në mbështetje të ligjit nr.107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Diber nr.88, datë 05.12.2025 *“Miratimin e familjeve që përfitojnë nga programi social “Subvencionimi i interesave të kredisë” i financuar me fondet e buxhetit të shtetit, në Bashkinë Diber*, u konstatua se:

Akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi bën pjesë në kategorinë e akteve me karakter individual, për pasojë nuk është kompetencë e Prefektit të shprehet për ligjshmërinë e kësaj vendimmarrje.

Hyrja në fuqi e akteve administrative të kësaj natyre, bëhet sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 55/6 të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHU





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

VENDIM

Nr. 88 Datë 05 / 12 /2025

**“MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL
“SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË” I FINANCUAR ME FONDET E
BUXHETIT TË SHTETIT, NË BASHKINË E DIBRËS”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar, vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, vendimit nr. 453, datë 03.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, të ndryshuar, njoftimin publik nga Bashkia Dibër "Thirrje për aplikime - Kërkesë për të përfituar nga programi i strehimit social, "subvencion i interesave të kredisë"" me nr. 3560 prot., datë 15.09.2025, dhe në vijim të shkresës nr. 407/53 prot., datë 01.08.2022, shkresës nr. 15406 prot., datë 06.12.2024, shkresës nr. 15406/2 prot., datë 16.01.2025, adresuar Bashkisë Dibër nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Mbi programin e subvencionimit të interesave të kredisë”, Vendim nr. 52, datë 30/09/2024, të Këshillit Bashkiak Dibër “Për miratimin e sistemit të pikëzimit”, pas shqyrtimit të dokumentacionit si dhe relacionit bashkëngjitur dhe propozimit të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **05.12.2025** me 17 vota pro 0 kundër 3 abstenim :

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së individëve/familjeve përfituese nga programi social “Subvencionimi i interesave të kredisë”, i financuar me fondet e buxhetit të shtetit, sipas Tabelës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Individët/familjet e përcaktuara në Tabelën nr. 1 të këtij vendimi, të paraqiten pranë institucionit bankar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga momenti i njoftimit që kryen Bashkia Dibër. Kur subjektet përfituese sipas këtij vendimi, nuk kanë gjetur ende një banesë, mund të paraqiten pa kaluar afatit 6 muajor pranë institucionit financiar bankar dhe institucionit monitorues të subvencionit të kredisë, Entit Kombëtar të Banesave, duke kërkuar shtyrjen e këtij afati edhe për 6 (gjashtë) muaj të tjerë. Në rast se subjektet përfituese, nuk kanë gjetur ende një banesë apo nuk kanë kërkuar shtyrjen e afatit, sipas parashikimit të kësaj pike, subjekti do të konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e përfitimit të subvencionimit të interesave të kredisë.

3. Drejtoria Juridike, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit pas ezaurimit të procedurave të parashikuara në këtë vendim të dërgojë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Entit Kombëtar të Banesave si edhe institucioneve financiare me të cilat është nënshkruar marrëveshje, një kopje të këtij vendimi së bashku me listat e përfituesve.
4. Individët/familjet që nuk janë shpallur përfitues nga programi social "Subvencionimi i interesave të kredisë", kanë të drejtën e ankimit administrativ, pranë kryetarit të Bashkisë ose personit të autorizuar prej tij, brenda 5 ditëve pune nga momenti i shpalljes publike të listës së përfituesve. Ankimi dorëzohet pranë Drejtorisë Juridike, e cila së bashku me dosjen e ankuesit ia paraqet kryetarit të Bashkisë, apo personit të autorizuar prej tij, i cili brenda 7 ditëve pune del me vendim në lidhje me ankimin e paraqitur nga ankuesit.
5. Ngarkohen kryetari Bashkisë Dibër, Drejtoria Juridike, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmërinë ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.
7. Vendimi u shpall më datë **05.12.2025**.

Kryetar i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA JURIDIKË, PROKURIMEVE DHE PRONAVE
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË PRONAVE DHE STREHIMIT

PROJEKT - PROPOZIM

Nr. 08, datë 19.11.2025

PËR

**"MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL
"SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË" I FINANCUAR ME FONDET E
BUXHETIT TË SHETIT, NË BASHKINË E DIBRËS"**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", të ndryshuar, vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", vendimit nr. 453, datë 03.07.2019, të Këshillit të Ministrave "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti", të ndryshuar, njoftimin publik nga Bashkia Dibër "Thirrje për aplikime - Kërkesë për të përfutur nga programi i strehimit social, "subvencion i interesave të kredisë" me nr. 3560, datë 15.09.2025, dhe në vijim të shkresës nr. 407/53 prot., datë 01.08.2022, shkresës nr. 15406 prot., datë 06.12.2024, shkresës nr. 15406/2 prot., datë 16.01.2025, adresuar Bashkisë Dibër nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit "Mbi programin e subvencionimit të interesave të kredisë", Vendimit nr. 52, datë 30/09/2024, të Këshillit Bashkiak Dibër "Për miratimin e sistemit të pikëzimit", pas shqyrtimit të dokumentacionit në komisionin e Strehimit, si dhe relacionit bashkëngjitur, Kryetari i Bashkisë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të datës _____.2025,

PROPOZON:


1. Miratimin e Raportit Përmbledhës të komisionit të strehimit dhe listën e individëve/familjeve përfituese nga programi social "Subvencionimi i interesave të kredisë", i financuar me fondet e buxhetit të shtetit, sipas Tabelës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Individët/familjet e përcaktuara në Tabelën nr. 1 të këtij vendimi, të paraqiten pranë institucionit bankar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga momenti i njoftimit që kryen Bashkia Dibër. Kur subjektet përfituese sipas këtij vendimi, nuk kanë gjetur ende një banesë, mund të paraqiten pa kaluar afatit 6 muaj pranë institucionit financiar bankar dhe institucionit monitorues të subvencionit të kredisë, Entit Kombëtar të Banësve, duke kërkuar shtyrjen e këtij afati edhe për 6 (gjashtë) muaj të tjerë. Në rast se subjektet

përfutuese, nuk kanë gjetur ende një banesë apo nuk kanë kërkuar shtytjen e afatit, sipas parashikimit të kësaj pike, subjekti do të konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e përfitimit të subvencionimit të interesave të kredisë.

3. Drejtoria Juridike, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit pas ezaurimit të procedurave të parashikuara në këtë vendim të dërgojë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Entit Kombëtar të Banesave si edhe institucioneve financiare me të cilat është nënshkruar marrëveshje, një kopje të këtij vendimi së bashku me listat e përfutuesve.
4. Individët/familjet që nuk janë shpallur përfutues nga programi social "Subvencionimi i interesave të kredisë", kanë të drejtën e ankimit administrativ, pranë kryetarit të Bashkisë ose personit të autorizuar prej tij, brenda 5 ditëve pune nga momenti i shpalljes publike të listës së përfutuesve. Ankimi dorëzohet pranë Drejtorisë Juridike, e cila së bashku me dosjen e ankuesit ia paraqet kryetarit të Bashkisë, apo personit të autorizuar prej tij, i cili brenda 7 ditëve pune del me vendim në lidhje me ankimin e paraqitur nga ankuesit.
5. Ngarkohen kryetari Bashkisë Dibër, Drejtoria Juridike, Sektori i Administrimit të Pronave dhe Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmërinë ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

**Përgjegjës i Sektorit të Pronave dhe
Strehimit**

Gazmend Miftari



Drejtori Juridik

Ismet Saraçi



KRYETARI
Rahim SPAHIU

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKUESI**

Lotendo Cibaku



Tabela nr. 1. Lista e individëve/familjeve përfituese nga programi social “Subvencionimi i interesave të kredisë”, i financiar me fondet e buxhetit të shtetit

Nr. Rendor	Emri/Atësia/Mbiemri	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit që përfiton	Kushtet e strehimit (neni 16, germa (a))	Kushtet familjare (neni 16, germa (b))	Kushtet sociale (neni 16, germa (c))	Të ardhurat mujore neto të familjes	Punësimi	Kufiri maksimal i kredisë që përfiton familja	Numri i kontaktit
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Admir Rami Saraçi	4	2+1	nuk disponojnë banesë në pronësi	-	-	40.000	shtet	3.726.000	0697277009
2	Bledar Midil Brahasani	5	3+1	nuk disponojnë banesë në pronësi	Familje e re	-	109.900	shtet, privat	4.600.000	0685270249
3	Burbuqe Xhevat Cibaku	2	1+1	nuk disponojnë banesë në pronësi	Familje njëprindërore që ka në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna	-	56.654	shtet	2.530.000	0686876832
4	Erjon Bujar Torba	3	2+1	nuk disponojnë banesë në pronësi	Familje e re	-	34.149	shtet	3.726.000	0688540064
5	Lutfi Fetah Lleshi	4	2+1	nuk disponojnë banesë në pronësi	-	-	60.000	privat	3.726.000	0684271352

Mbyllur me numër rendor 5 (pesë).

Përgjegjës i Sektorit të Pronave dhe Strehimit

Gazmend Miftari



Drejtori Juridik

Ismet Saraçi



KRYETARI
Rahim SPAHIU

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKIMETARI**

Korenc Cibaku



RELACION SHPJEGUES
MBI PROJEKT - PROPOZIMIN
“PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL
“SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË” NË BASHKINË E DIBRËS”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, të ndryshuar, vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, vendimit nr. 453, datë 03.07.2019, të Këshillit të Ministrave “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, të ndryshuar, është bërë njoftimi publik “Thirrje për aplikime - Kërkesë për të përfutur nga programi i strehimit social, “subvencion i interesave të kredisë” me nr. 3560, datë 15.09.2025.

Me anë të shkresës nr. 407/53 prot. datë 01.08.2022 adresuar Bashkisë Dibrë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, jemi vënë në dijeni mbi numrin e 21 kuotave dhe shumat maksimale të kreditimit për Bashkinë Dibrë. Me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.57 datë 30.10.2024, nga këto kuota janë miratuar 9 familje përfituese dhe me VKB Dibrë nr. 44 datë 03.09.2025 janë miratuar 7 familje përfituese. Në vijim të ezaurimit të këtyre kuotave dhe njoftimit për zgjerimin me 7 kuota të reja me anë të shkresës nr. 15406 prot., datë 06.12.2024 adresuar Bashkisë Dibrë nga MEKI, ku në vijim të kësaj shkrese, shkresës nr. 15406/2 prot., datë 16.01.2025 nga ana e MEKI na është sqaruar si më poshtë:

- Bashkitë, të cilat kanë ende kuota të lira nga hapja e programit të subvencionimit të interesave të kredive nga viti 2019 apo nga viti 2022, të vijnë ta zbatojnë këtë program me kushtet e përcaktuara në shkresën nr. 15406/2024

Programi Social i Strehimit për “Subvencionimin e interesave të kredisë” synon të mbështesë në blerjen e shtëpive të para, me qëllim përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës. Nga programi i subvencionimit të interesave të kredive do të përfitojnë ato familje/individë që nuk disponojnë banesë në pronësi. Përparësi në përzgjedhje do të kenë:

- çiftet e reja dhe të rinj me moshë deri në 40 vjeç;
- individë/familje të minoritetit rom dhe egjiptian;
- familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë;
- familjet me më shumë se katër fëmijë;
- gra kryefamiljare/gra të dhunuara.

Përparësitë e përcaktuara më sipër nuk përjashtojnë individë a familje që nuk bëjnë pjesë në këto familje. Çdo individ/familje përfituese mund t'i drejtohet institucioneve financiare me të cilat është nënshkruar marrëveshje, për të marrë ofertën që i përshtatet më mirë kushteve të tij/saja dhe më pas të vijnë me bankën që përzgjedh vetë.

Me shpalljen e thirrjes, nëpërmjet sistemit e-albania në total kanë aplikuar 6 familje. Pasi janë njoftuar për plotësimin e plotë të dokumentacionit për aplikuesit, rezultoi se 5 familje janë kualifikuar si përfitues të këtij programi dhe i aplikim me mungesë dokumentacioni. Për vlerësimin e nivelit të të ardhurave të familjeve, sipas nenit 2, pika 45, të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, Bashkia Dibrë i është referuar shpenzimeve mesatare sipas shkresës së MEKI nr. 12836 Prot., datë 13/11/2024 pasqyruar në tabelën nr.2, ndërsa pikëzimi është

bazuar vendimit nr. 52, datë 30/09/2024. të Këshillit Bashkiak Dibër "Për miratimin e sistemit të pikëzimit".

Në vijim të shqyrtimit, vlerësimit, pikëzimit, dhe miratimit është ndërtuar formati i listës emërore me familjet përfituese sipas kushteve të përcaktuara në ligj dhe kalimin e këtyre aplikimeve për vlerësim komisionit të strehimit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit në komisionin e Strehimit, kërkohet të jepet miratimi i individëve/familjeve përfituese nga programi social "Subvencionimi i interesave të kredisë", i financuar me fondet e buxhetit të shtetit sipas tabelës numër 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij projekt-vendimi.

Tabelë nr.2. Vlerësimi i nivelit të të ardhurave të familjeve nga Bashkia Dibër, sipas nenit 2, pika 45, të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social", referuar shpenzimeve mesatare sipas shkresës së MEKI nr. 12836 Prot., datë 13/11/2024.

(në lekë)

Të ardhurat e familjeve	Madhësia e Njef					Strehimi konsiderohet i përballueshëm sipas nenit 3, nëse familja me të ardhura
	Familje me një person	Familje me 2 persona	Familje me 3 persona	Familje me 4 persona	Familje me 5+ persona	
Familje me të ardhura mesatare	51,646-61,975	64,616-77,539	60,895-73,074	78,459-94,151	92,349-110,819	a) mesatare nuk shpenzon më shumë se 25 për qind të të ardhurave të saj mujore për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm
Familje me të ardhura të ulëta	36,152-51,646	45,231-64,616	42,627-60,895	54,921-78,459	64,644-92,349	b) të ulëta nuk shpenzon më shumë se 20 për qind të të ardhurave të saj mujore për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm
Familje me të ardhura shumë të ulëta	më pak se 36,152	më pak se 45,231	më pak se 42,627	më pak se 54,921	më pak se 64,644	c) shumë të ulëta nuk shpenzon më shumë se 15 për qind të të ardhurave të saj mujore për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm
Familje pa të ardhura	ç) familje me ndihmë ekonomike, si dhe ato që përveç ndihmës ekonomike përfitojnë pagesat sipas paragrafit të dytë të pikës 44 të këtij neni.					

Spektori i Pronave dhe Strehimit

Juriste
Xhesika Rama

Drejtori Juridik
Ismet Saraçi

Specialist
Mentor Bitri

Përgjegjës
Gazmend Miftari

KRYETARI
Rahim SPAHIU

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI

